



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 02/1764

Dt. 10/09 /2026

Në mbështetje të nenit 33 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan dhe pas shqyrtimit të Propozimit të u.d. Rektores nr. 01/1558, të datës 05.08.2026, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më datë 07.09.2026, merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Propozimi i u.d. Rektores nr. 01/1706, i datës 04.09.2026, për rritjen e numrit të prorektorëve të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan.
- II. Numri i prorektorëve të Universitetit Publik "Kadri Zeka" rritet nga katër (4) në pesë (5) prorektorë.
- III. Përkatësisht krijimin e pozitës së Prorektorit për Buxhet, Financa dhe Kontabilitet..
- IV. U.d. Rektorja autorizohet që, në përputhje me Statutin e Universitetit, t'i propozojë Këshillit Drejtues kandidatin për prorektorë sipas fushave të përcaktuara në pikën III të këtij vendimi.
- V. Obligohen njësitë kompetente të Universitetit që të ndërmarrin veprimet e nevojshme administrative dhe financiare për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me planifikimin buxhetor për vitin 2026.
- VI. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

U.d. Rektorja, me Propozimin nr. 01/1706, të datës 04.09.2026, i ka propozuar Këshillit Drejtues rritjen e numrit të prorektorëve nga katër (4) në pesë (5), duke u mbështetur në nevojat aktuale organizative dhe strategjike të Universitetit, shtimin e vëllimit të punës dhe domosdoshmërinë e shpërndarjes më funksionale të përgjegjësisve në kuadër të menaxhmentit të lartë.

Këshilli Drejtues, pas shqyrtimit të propozimit dhe arsytimit të paraqitur, vlerësoi se organizimi i menaxhmentit me pesë (5) prorektorë mundëson mbulimin më efektiv të fushave të mësimdhënies dhe çështjeve të studentëve, zhvillimit akademik dhe cilësisë, hulumtimeve dhe kërkimeve shkencore, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe projekteve dhe fushën e financave dhe infrastrukturës.

Neni 33 i Statutit përcakton se Universiteti ka tre (3) prorektorë dhe se, përjashtimisht, me propozim të arsyetuar të Rektorit dhe me miratim të Këshillit Drejtues, numri i tyre mund të rritet deri në pesë (5). Duke qenë se propozimi është arsyetuar dhe rritja e kërkuar është brenda kufirit statutar, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Dr.Sc. Lizë Rexhepi

Kryesuese e Këshillit Drejtues në UKZ

Vendimi u dërgohet:

1. U.d.Rektores;
2. Këshillit Drejtues;
3. Senatit të Universitetit;
4. Sekretarit të Përgjithshëm;
5. Zyrës Ligjore;
6. Departamentit të Buxhetit dhe Financave;
7. Menaxherit të Personelit;
8. Njësive akademike dhe organizative;
9. Arkivit të Universitetit.